



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Ekonomisë shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	8
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	06/12/2021
Afati për aplikim	21/12/2021 - 28/12/2021
Institucioni	Ministria e Ekonomisë
Departamenti	Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Divizioni	Divizioni për Komunikim Publik
Vendi i punës	Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun
Nr. i Referencës	RN00007933
Kodi	RPC0001739



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin harton, zhvillon dhe zbaton planin e komunikimit për të informuar qytetarët dhe institucionet për politikat, arritjet dhe aktivitetet e ministrisë dhe siguron redaktimin dhe përditësimin e tyre;
2. Mirëmban dhe përditëson rrjetet sociale dhe realizon (montimin e foto/ video/audio materialeve) dokumentimin vizual (fotografi & video) të aktiviteteve të Ministrisë, në bazë të planit dhe kërkesave;
3. Përgatit komunikata, ftesa, informata, raporte dhe publikime tjera për publikun dhe pas miratimit të tyre nga mbikëqyrësi dhe menaxhmenti i ministrisë i shpërndan tek mediat e shkruara, elektronike dhe tek zyrtari për publikim në ueb faqen e ministrisë;
4. Menaxhon në mënyrë të përditshme ndërlidhjen e ministrisë me mediat si dhe gazetarët kryesor me të cilët punohet në baza të rregullta veçanërisht me gazetarët të fushës së ekonomisë si dhe fushave që mbulon Ministria;
5. Ndjek të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet e Ministrisë dhe të Ministrit/es, duke bërë fotografimin, incizimin dhe arkivimin e tyre, si dhe përgatit materialin vizual dhe të shkruar për këto ngjarje;
6. Përgatit dhe mbikëqyrë materialet për publicitet, të prospekteve, të fletëpalosjeve, të videove të ndryshme për promovim, të fotografive, të filmave dhe të programeve në media të ndryshme;
7. Në bashkëpunim me Njësitë Përkatëse të Ministrisë dhe Kabinetin e Ministres përgatit përgjigjet për kërkesat/pyetjet lidhur me aktivitet dhe shërbimet e ministrisë të pranuar nga; mediat e shkruara dhe elektronike, OJQ-të si dhe nga publiku.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor), në drejtimet: Gazetari, Marrëdhënie me Publikun, Komunikim Masiv (Produksion, Media Dixhitale dhe Komunikimi, Kamera dhe Fotografia, Arti dhe Media Dixhitale si dhe Dizajni Grafik)
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën përkatëse në të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.
- Njohuri të mira në përdorimin e kamerës, fotoapararit, montimit dhe realizimit të video informatave, infografikave dhe buletinëve online.
- Njohuri në programet: Word, Excell, Power Point, Outlook, programe dizajni dhe aftësi të mira në përdorimin e multimedive.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 04/01/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Prishtinë, 20/01/2022, ora 10, Ministria e Ekonomisë Adresa: Ndertesha ish- Toskana /Rr. Nëna Terezë,

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

Pyetjet në Intervistë do të jenë nga Ligji për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L- 114 si dhe nga fushë veprimtaria e komunikimit publik

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

